



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 01.6.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Evgjani
Thaçi-Dragusha, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Munguan: Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe
Elmi Reçica.

Pjesëmarrësit e tjerë: Butrint Berisha, PIPS; Rabije Hyseni, Fitore Sopjani, Egesa Vitia,
praktikante dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 3 e 26 prill dhe 4 maj 2018;
3. Funksionalizimi i grupeve të miqësisë;
4. Diskutim lidhur me gjendjen në shërbimin e jashtëm;
5. Të ndryshme.

1. Miratim i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 3 e 26 prill dhe 4 maj 2018;

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 3 e 26
prill dhe 4 maj 2018.*

3. Funkcionalizimi i grupeve të miqësisë;

Vjosa Osmani Sadriu, njoftoi se Komisioni ka dërguar analizën dhe propozimin e tij për funksionalizimin e grupeve të miqësisë ekzistuese si dhe krijim e dhjetë grupeve të reja të miqësisë, në Kryesinë e Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, tha ajo se i ka marr disa emra nga grupet parlamentare, mirëpo një numër i madh i grupeve parlamentare ende nuk i ka dërguar emrat për plotësimin e këtyre grupeve. Ajo po ashtu njoftoi se Kryesia nuk ka kërkuar nga grupet parlamentare që të dërgojnë emrat për dhjetë grupet e reja të miqësisë edhe pse është pajtuar për themelimin e tyre. Ajo propozoi që Komisioni t'i adresohet Kryesisë së Kuvendit për themelimin e dhjetë grupeve të miqësisë, që nuk janë themeluar sipas propozimit të Komisionit; t'i adresohet grupeve parlamentare që t'i dërgojnë emrat për t'i plotësuar grupet e miqësisë dhe ti dërgohet shkresë kryetarëve të grupeve të miqësisë që të konstituohen këto grupe deri më 30 qershor 2018.

Zafir Berisha, në lidhje me funksionalizimin e grupeve të miqësisë njoftoi se edhe në legjislaturën e kaluar kjo çështje është vonuar duke pas parasysh rëndësinë e grupeve të miqësisë dhe mundësinë e komunikimit me të gjitha shtetet për lobim dhe për ta pasqyruar realitetin në Kosovë. Berisha pyeti se në çfarë mënyrë janë ndarë grupet, për shkak se në shumë grupe nuk ka përfaqësues të grupit parlamentar të NISMA-ës.

Vjosa Osmani Sadriu, duke iu referuar pyetjes së deputetit Berisha, njoftoi se sa i përket udhëheqjes së këtyre grupeve nuk është e njoftuar, kurse sa i përket anëtarësisë shprehu mendimin se secili grup parlamentar duhet ta ketë së paku një anëtar në secilin grup të miqësisë, pasi që koncepti i grupeve të miqësisë është koncept vullnetar. Ajo po ashtu njoftoi se sipas rregullores për formimin e grupeve të miqësisë, një deputet mund ta udhëheq vetëm një grup të miqësisë.

Pas diskutimeve Kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Ti propozohet sërish Kryesisë së Kuvendit:

- I. *Të formohen grupet e miqësisë të deputetëve tanë me homologët e vendeve të tjera si vijon:*
 1. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Republikën e Çekisë;*
 2. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Republikën e Koresë;*
 3. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Norvegjinë dhe Islandën;*
 4. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Tajlandën;*
 5. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Bosnje e Hercegovinën;*
 6. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Izraelin;*
 7. *Të formohet Grupi i Miqësisë me Jordaninë;*
 8. *Të formohet Grupi i Miqësisë për Afrikën Veriore;*
 9. *Të formohet Grupi i Miqësisë për Afrikën Qendrore e Jugore;*
 10. *Të formohet Grupi i Miqësisë për vendet e Lindjes së afërt.*
- II. *Të përcaktohen kryetarët dhe nënkryetarët e grupeve të miqësisë për ato grupe të miqësisë të formuara, bazuar në Vendimin e Kryesisë Nr. 06-076 të dt.5.2.2018, që ende nuk janë përcaktuar dhe për grupet e miqësisë të propozuara për formim sipas pikës I të këtij Propozimi.*

III. Të kërkohet nga Shefat e grupeve parlamentare që të plotësohet përbërja e grupeve të miqësisë me qëllim të funksionalizimit të tyre dhe deri më 30 qershor 2018 të mbahen takimet e tyre konstitutive.

4. Diskutim lidhur me gjendjen në shërbimin e jashtëm;

Vjosa Osmani i njoftoi anëtarët e Komisionit se ministrit të jashtëm është duke iu dërguar ftesa për të raportuar në komision çdo javë, në lidhje me procesin e njohjeve dhe gjendjen në shërbimin e jashtëm, por ende nuk kemi përgjigje. Ajo theksoi se lidhur me procesin e njohjeve është e nevojshme që të koordinohen të gjitha institucionet në Republikën e Kosovës, që të ngritet numri i njohjeve.

Osmani vuri në pah se ministri i MPJ-së në takimin e fundit ka premtuar se do të sjellë një varg dokumentesh në Komision, se do të përgjigjet në disa nga pyetjet e anëtarëve e po ashtu do të ndërmarrë masa për plotësimin e kriterit të 50% për emërimet e jashtme, por deri më tani Komisioni nuk ka ndonjë informatë.

Ajo njoftoi Komisionin se nga MPJ-ja ka dy propozime për dëgjime në Komision për emërimet në pozitën e ambasadorëve, të cilat në besim ju shpërndanë anëtarëve të Komisionit. Më tej kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se tani nga MPJ-ja po i përcillen Komisionit emra të kandidatëve për dëgjim, të cilët janë dëgjuar në legjislaturat e kaluara, që është një praktikë e cila nuk është aplikuar deri më tani, përderisa në anën tjetër emërohen kandidatë për shef misioni apo ambasador, në mënyrë të kundërligjshme pa u dëgjuar fare dhe pa raport të Komisionit.

Pas diskutimit në lidhje me shërbimin e jashtëm, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të kërkohet interpretim ligjor nga MPJ-ja bazuar në ligjet në fuqi, për emërimin e kandidatëve në pozitë të shefit të misionit apo ambasadorit pa raport të Komisionit dhe për arsyet e propozimit që të dëgjohen në Komision sërish kandidatët e dëgjuar më parë, në legjislaturat e kaluara për të njëjtën gradë.

5. Të ndryshme

Vjosa Osmani Sadriu njoftoi lidhur me funksionalizimin e dy grupeve punuese të Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve. Lidhur me mbështetjen e organizatës joqeveritare PIPS në punën e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm ftoi anëtarët e Komisionit që të përgjigjen në pyetësorin e punuar nga ata, i cili tha se ka për qëllim lehtësimin e punës së grupit punues.

Time Kadrijaj, njoftoi Komisionin se me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve është propozuar që të bashkëpunohet në mes të dy grupeve dhe në këtë drejtim do të ishte e nevojshme që së bashku të realizojnë vizitë pune në Francë e Suedi

Vjosa Osmani Sadriu, propozoi që me rastin e realizimit të këtyre vizitave në funksion të mbikëqyrjes së ligjeve, të tentohet që në këto vende të organizohen edhe takime me institucione në këto shtete për çështje të tjera.

Evgjeni Thaçi Dragusha, njoftoi për takimin e parë të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën, me ç'rast mes tjerash ftoi anëtarët e grupit punues të angazhohen në punën e grupit. Ajo theksoi se grupi i punës ka paraparë në fillim të qershorit një takim pune në Ministri e po ashtu e përkrahu propozimin e grupit tjetër punues për organizim të përbashkët të vizitave jashtë vendit në funksion të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Kryetarja e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.